

Kryetari i Komunës, në baz të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Obligohet** Drejtoria e Administratës – Sektori i Gjendjes Civile dhe Zyra e Pritjes nga data 15.07.2023 deri me 20.08.2023 që të punojnë çdo ditë pune me palë nga ora 07:30 deri 17:00, gjatë ditëve të shtuna nga ora 09:00 deri në ora 13:00.
2. **Obligohet** Drejtoria e Urbanizmit – Sektori i Kadastrit nga data 15.07.2023 deri me 20.08.2023 që të punojnë çdo ditë pune me palë nga ora 07:30 deri 17:00, gjatë ditëve të shtuna nga ora 09:00 deri në ora 13:00.
3. Zbatimi i orarit të punës sipas pikes 1 dhe 2 të këtij vendimi të bëhet për shkak të rritjes së numrit të kërkesave për shërbime të Zyrës së Gjendjes Civile dhe Sektorit të Kadastrit me rastin e ardhjes së bashkëatdhetarëve të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës.
4. Për nëpunësit civil të cilët do të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës të përcaktuar me këtë vendim të aplikohen dispozitat ligjore në fuqi (kompenzim për orë shtesë apo shfrytëzim i ditëve të lira për numër të orëve të punës).
5. Drejtoria për Administratë në bashkëpunim me Zyrën për Informim të ndërmarrë masa për informimin e qytetarëve, përmes faqes zyrtare të Komunës ashtu edhe në format tjera të informimit public në mënyrë që qytetarët të jenë sa më të informuar me këtë vendim.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë së Administratës
- Drejtorisë së Urbanizmit
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

